

SUBJEKTI "PAJO 2010" SHPK

URA VAJGURORE

***PERMBLEDHJE
JO TEKNIKE
E RAPORTIT TE VLERESIMIT
TE NDIKIMIT NE MJEDIS***



Investitor: Subjekti "PAJO 2010" shpk Ura Vajgurore

Projektoi: "STUDIOPROJEKT" shpk Tirane

Tirane 2021



PERMBAJTJA

Lloji mineralit

Te dhena per subjektin

Pershkrim i shkurter projektit te propozuar

- Hyrje
- Objekti projektit te propozuar
- Te dhena teknike te projektit

Vendndodhja e projektit.

Ndertimi gjeologjik i vendburimit

Te dhena mbi llojin e mineralit

Kushtet hidrogeologjike te vendburimit

Kushtet tekniko minerare

Tektonika

Variant i hapjes se vendburimit

Sistemi shfrytezimit treguesit tekniko-ekonomik

Radha dhe drejtimi i shfrytezimit

Elementet gjeometrik te karieres

Vleresimi i ndikimit ne mjedis

Kerkesat e studimit te vleresimit te ndikimit ne mjedis

Korniza e kuadrit ligjor

Metoda e pergatitjes se VNM

Kerkesat sociale

Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

Qellimi dhe objektivat e VNM

Kuadri ligjor kombetar

Metodologjia e Vleresimit

Rezultatet e priteshme te investimit

Investimet per rehabilitimin.

Gjeografia e zones

Popullsia

Klima

Hidrografia

Hidrologjia

Bimesia

Infrastruktura ekzistuese

Ekonomia e zones dhe aktiviteti kryesor

Cilesia e ajrit

Zhurmat

Mjedisi biologjik zonat e mbrojtura

Flora dhe fauna.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis dhe masat parandaluese

-Te pergjitheshme

Vleresimi i impakteve ne mjedis

Projektoi: "STUDIOPROJEKT" shpk. Tirane

Adresa: Rr. Ndre MJEDA, Rezidenca Eagle, njesia 3006. Tirane

Telefon: 0682056654

e- Mail: studioprojekt@yahoo.it

Objektivat e mbrojtjes se mjedisit
Ndikimi ne ajer, cilesia e ajrit, zhurmat, vibracionet, pejsazhi
Ndikimi ne ujrat sipërfaqore dhe nentokesore.
Ndikimi ne token, relieve, sipërfaqja, perberja e structures se tokes.
Ndikimi ne biodiversitet, floren dhe faunen.
Ndikimi ne mjedisin social-ekonomik, mjedisi social-kulturor dhe ekonomikperdorimi i tokes,
perdorimi i burimeve ujore
Ndikimet qe shkaktojne ndryshime klimatike
Ndikimet nderkufitare
Menaxhimi i mbetjeve
Plani i menaxhimit te mjedisit dhe konsultimi me publikun e palet e nteresit
-Te pergjithshme
Plani i menaxhimit te mjedisit te demtuar nga zbatimi i projektit
Aspektet sociale,konsultimi dhe informimi i publikut
Monitorimi i mjedisit gjate zbatimit te punimeve te ndertimit dhe te rehabilitimit te mjedisit
konkluzione dhe rekomandime për projektin
Përfundime .
Rekomandime

**PERMBLEDHJE JO TEKNIKE
E RAPORTIT TE THELLUAR TE VLRESIMIT TE NDIKIMIT NE
MJEDIS PER AKTIVITETIN E SHFRYTEZIMIT ME KARIERE TE
GURIT GELQEROAR NGA SUBJEKTI "PAJO 2010" shpk
NE ZONEN MINERARE Nr.376/5
OBJEKTI KANIZBALT RRETHI BERAT**

Lloji mineralit

Objekti i gurit gelqeror KANIZBALT rrethi BERAT per te cilen kerkohet leje minerare, bazuar në ligjin 10304 , datë 15.07.2010, te ndryshuar " Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i përket grupit të materialeve ndertimore.

Te dhena per subjekti

Subjekti "PAJO 2010" shpk eshte shoqeri private dhe ushtron aktivitet tregtar dhe ndertime ne teritorin e qarkut Berat .

Materjalet e prodhuara ne kariere "guri gelqeror" do perdoret ne gjendje natyrale per ndertime ne infrastrukturen rrugore , prodhim inertesh, si, rere suvatimi, rere betoni, granile, stabilizant, etj, per nevoja e vete subjektit dhe per te trete.

Punimet e hapjes pergatitjes dhe shfrytezimi te gurit gelqeror ne karjere do te behen duke zbatuar teknologji bashkekohore, te cilat parashikohen ne projektin perkates.

Prodhimi i gurit gelqeror ne shkallet e karjeres, ngarkimi, transporti dhe fraksionimi ne impjantin e inerteve, do te behet me makineri cilesore, te cilat disponohen nga kerkuesi i lejes minerare.

Emir dhe adresa e subjektit

Emri i subjektit	"PAJO 2010 " shpk.
Adresa	URA VAJGURORE
Administrator	Hajredin PAJO

PERSHKRIM I SHKURTER I PROJEKTIT TEPROPOZUAR

Hyrje

Vendi ynë aktualisht është duke u përballur me sfidat e integritit në Bashkimin Evropian, gjë e cila përfshin angazhimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja ekonomike, përshtatjen e teknologjive, si dhe integrimin e ekonomisë shqiptare në hartën e tregjeve rajonale dhe ndërkombëtare. Ky përbën një proces kryesor për të garantuar koherencën dhe vazhdimësinë e strategjive, të reformave, si dhe të prioritetëve të ekonomisë shqiptare, të cilat janë të nevojshme në kushtet e një ekonomie të tregut të lire. Arritja e këtyre objektivave parësore do të behet e mundur nëpërmjet politikave efektive, konsolidimit dhe zhvillimit të sektorëve kryesorë të ekonomisë kombëtare, konsolidimit të institucioneve dhe hartimit e implementimit të projekteve, të cilët realisht do ta integrojnë ekonominë Shqiptare, duke u bazuar në drejtimit kryesorë të "Strategjisë Kombëtare për Zhvillimit dhe Integritit", si dhe në strategjitë sektoriale dhe rajonale. Përpjekjet konstante për harmonizimin e politikave të rritjes ekonomike me kërkesat e standardeve mjedisore, përbejnë gjithashtu një drejtim tjetër themelor të programeve të Qeverisë për një zhvillim të qëndrueshëm të vendit. Eksperienca e vendeve të zhvilluara ka treguar se, për të pasur një zhvillim normal të sektorit industrial duhet të vendoset një balancë e drejtë ndërmjet politikave qeverisëse dhe mekanizmave të tregut, si dhe menaxhimit të energjisë.

Ky aktivitet ka si synim shfrytëzimin e mineraleve ndërtimor gur gelqeror në vendburimin e KANIZBALT, rrethi BERAT. Subjekti ka të qarte rrugën dhe hapat për ta realizuar këtë projekt në variantin e tij më optimal.

Nëpërmjet këtij raporti të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis do të jepet një informacion i detajuar i projektit të shfrytëzimit, informacion mbi zonën dhe popullsinë e saj, punimet që do të kryhen, ndikimet në mjedis nga zbatimi i projektit, masat që duhet të merren për minimizimin e këtyre ndikimeve, si dhe impaktin ekonomik-social.

Projekti i Propozuar

Objekti i projektit të propozuar.

Objekti i projektit të propozuar është shfrytëzimi i mineralit të gurit gelqeror në zonën minerare 376/5, pranë fshatit KANIZBALT, të rrethit BERAT.

Sipërfaqja ku do të zbatohet projekti është 0.0305 Km², ose 3.05ha.

Te dhënat teknike të projektit janë si më poshtë:

Bashkëgjatur japim volumet e mineralit të gurit gelqeror projektuar për shfrytëzim me kariere për prodhim inertesh dhe organizimin e punës

1-Sasia e prodhimit të projektuar me kariere	500 000 m ³
2-Koha e aktivitetit	25 vjet
3-Prodhi vjetor i vitit të parë	00 m ³
4-Prodhi vjetor	20 000 m ³
5-dite punë në vit	252 dit/vit
6-Prodhi ditor	75 m ³ /dite
7-Prodhi mujor	1667 m ³ /muaj

Projektoi: "STUDIOPROJEKT" shpk. Tirane

Adresa: Rr. Ndre MJEDA, Rezidenca Eagle, njesia 3006. Tirane

Telefon: 0682056654

e-Mail: studioprojekt@yahoo.it

Gjeografia e topografia e zones

Nga pikpamja gjeografike terreni ku shtrihet objekti qe kerkohet per shfrytezim, eshte terren kodrinor. Vete terreni ku kerkohet te behet shtyrja e lejes minerare eshte i pak aksidentuar dhe i mbuluar me pishe. Ne siperfaqe vihen re sheshe te te zbuluara dhe te shfrytezuara te cilat jane shfrytezuat keto 10 vjet . Thellesia e prerjeve erozionale te krijuara nga gryerjet ne shume raste eshte e konsiderueshme

Kuota e poshem e zones se kerkuar per shfrytezmi eshte +100 ndersa ajo e siperme +180m

Nga pikpamja topografike objekti ka formen e nje strukture monoklinale me shtrirje te pergjitheshme me azimut 180^0 -J dhe me renie Lindore me azimut renie 90^0 dhe kend renie te terrenit 15^0 .

Popullsia, klima infrastruktura ekzistuese

Ppopullsia

Popullsia e kesaj zone i perket nje zone rurale dhe merret kryesisht me pune bujqesore dhe blegtorale. Ata banojne ne fshatrat perrreth me rreth 1000 banore, qe bejne pjese ne .

Klima.

Objekti i kerkuar ben pjese ne Zonen fushore kodrinore te zones klimatike mesdhetare.

Klima ne rajonin ku do te kryhen punimet e shfrytezimit dhe perpunimit te gurit gelqeror paraqitet kontinentale me dimer relativisht te ashper dhe te ftohte dhe vere te fresket dhe te ngrohete .

Dimri qe pergjithesisht eshte i ashper dhe me lageshti shoqerohet shpesh dhe me rreshje bore, te cilat, disa here, arrijne trashesin mbi 1 m duke shkaktuar bllokimin e perkohshem te rruges, ndersa vera e ngrohete me pak lageshti . Ne zone ka mbi 1650 ore ndricim dielli, korriku 2855 ore dhe dhjetori 75 ore. Temperatura mesatare vjetore e ajrit eshte 12.6 grade Celsius, ne Korrik dhe Gusht temperatura shkon 26-36 grade Celsius, ndersa ne janar zbret ne 6 grade Celsius, disa here dhe disa grade nen zero.

Vlera mesatare e rreshjeve shkon ne 2215 mm/vit. Ne periudhen tetor-maj bien 75% e rreshjeve.

Sasia maksimale e rreshjeve eshte rregjistruar gati 168 mm shi ne 24 ore (2006).

Lageshtia e ajrit rezulton sipas stineve nga 68% - 74%.

Drejtimi i ererave eshte kryesisht Veri Perendim –Juge Lindje qe perputhet me drejtimin e pergjithshem te lugines dhe ne raste te rralla oblik me te

Ushtrimi i aktiviteti te shfrytezimit dhe perpunimit te gurit gelqeror, duke mare ne konsiderate masat e parashikuara ne projekt, nuk do te ndikoje ne ndryshimin e parametrave fizike te ajrit dhe nuk do t'a ndote ate.

Parashikimi ne projekt i masave shtese gjate proceseve teknologjike te shfrytezimit si perdorimi i uje gjate kryerjes se proceseve teknologjike ne karriere dhe atyre te perpunimit te metejshem te gurit gelqeror sistematike si dhe sperkatja e stoqeve te gelqerorit dhe rrugeve te transportit do te parandalojne ngritjen e pluhurit dhe ndotjen e ajrit.

Perdorimi i makinerive te shpimit, zbankimit, ngarkimit dhe transportit te tipit per miniera do te beje te mundur kapjen dhe parandalimin e gazeve, qe emetohen nga motorat me djegie te brendeshme.

Hidrologjia dhe hidrografia e zones ne te cilen kufizohet objekti i shfrytezimit

Per nga pikpamja hidrologjike dhe hidrografike objekti i kerkuar ndodhet ne kushte te mira. Nuk vihen re burime natyrale ujrash. Pikerisht ne vendin ku kerkohet leja minerare ndodhet nje prroske e thelle, rreth 20 m, ne te cilen, ne stinen e thate nuk nuk rrjedhin ujra. Kur ka reshje, neper te rrjedhin me rrembim ujra siperfaqesore per shkak dhe te pjerresise mjaft te madhe te terrenit.

Bimesia.

Vendi ku kerkohet leja e shfrytezimit eshte pothuajse i zhveshur nga bimesia pasi shoqeria ka bere zbulimin e te gjiothe siperfaqes ne dhjete vite aktivitet. Ne aferi te saj (ne Jug te zones ne fjale) rriten pishe e larte. Ne zonen e dherave (mbuleses qe nuk perfaqeson rezerva gjeologjike argjilore) rriten lule dhe bar.

Infrastruktura ekzistuese.

Objekti i kerkuar per shtyrje afati i ka te perfunduar rruget brenda karrieres pasi shoqeria ka nje aktivitet dhjetevjeçar .

Ushtrimi i aktivitetit minerar ne vitet e fundit ka beret e mundur ndertimin e nje rrjeti shume te dendur rruges qe lidhin objektet e shfrytezimit me rrugen kryesore me teqen e gjurmes se kalit si dhe me ate qe levizin peligrinet per te shkuar ne festen e bektashinjeve ne malin e tomorit. Rruga kryesore dhe ato dytesore ne zone jane kryesisht ne gjendje te mire te pa shtruara dhe shfrytezimi i ketij objekti do te ndikojte dukshem ne permiresimin e infra se zones.


1.5 Ekonomia e zones dhe aktivite kryesore

Popullsia e kesaj zone i perket nje zone rurale dhe merret kryesisht me pune bujqesore dhe blegtorale si dhe nje pjese e tyre ne emigracion dhe ne aktivite te tjera pak te zhvilluara. Relativisht eshte ne gjendje ekonomike nen mesatare. Kohet e fundit zona ka marre zhvillim te dukshem si rezultat i shtimit te aktivitetit te shfrytezimit te pllakave te gurit gelqeror

Ky aktivitet perfaqson nje burim te rendesishem te ardhurash per banoret e kesaj zone dhe te fshatrave per rreth

Vend ndodhja e objektit

Objekti i gur gelqeror per te cilin hartohet studimi tekniko-ekonomik dhe projekti i shfrytezimit ndodhet ne territorin e fshatit KANIZBALT te rrethit BERAT, ne veri lindje te fshatit KANIZBALT ne nje distance rreth 2.5km larg ne vije ajrore Administrativisht i perket ndarjes administrative te rrethit te BERAT, qarku Berat Qendra administrative rurale e zones ne fjale eshte rrethi BERAT. Depozitimi i gelqeroreve objekti KANIZBALT, BERAT projektuar per shfrytezim me siperfaqe 0.305km² , brenda koordinatave te kufizuara ne harten topografike, me nomeklature K-34-88-B-c, sh 1:25 000, me pikat 1,2,3,4,5 perben fushen minerare.



Republika e Shqiperise SHOQERIA "PAJO 2010".shpk		STUDIM TEKNIKO-EKONOMIK I ZONES MINERARE Nr. 376/5 QARKU BERAT	
		HARTA GJEOLOGO TOPOGRAFIKE	
		"SUTDIO PROJEKT"shpk	
Shkalla	Viti	Ing. Min Xhevaier DERMISHI	
1: 25000	2015	Ing. Gjeol. Gogo GJIVOGLI	
		Ing. Topo. Luan BEJTJA	

Ndertimi gjeologjik i vendburimit.

Rajonin ku ndodhet vendburimi i gelqeroreve pllakore, eshte pjese e strukturen antiklinale te Konisbaltes, te zones Jonike .

Ndertimi gjeologjik dhe petrografik i kesaj zone ka qene objekt studimesh dhe pergjithesimesh te kryera nga Fakultetit te Gjeologjise dhe Minierave, publikimesh te ndryshme te Specialisteve te Institutit te Studimeve dhe Projekttimeve Gjeologjike ne buletin e Gjeologjise deri ne vitin 1990, punime e ndryshme te kryer per harten gjeologo strukture te vendit dhe se fundi ne kete zone jane kryer punime te shumta shfrytezimi kryesisht ne pjesen e siperm te prerjes

Ne ndertimin gjeologjik te kesaj zone marrin pjese formacione karbonatike te Kretakut ne shtrirje te vogel dhe Eocenit dhe formacione flishore te Oligocenit.

Kjo strukture ne berthame apo ne qender poshte ndertohtet nga depozitime karbonatike te Kretakut te siperm, qe jane gelqerore dolomitike e dolomite masive dhe ne qender larte ndetohen nga gelqerore e Eocenit, qe kryesisht jane gelqerore pllakore. Ne anet e kesaje strukture vendosen ne menyre diskordate dhe heraheres te doradorshme mbi gelqeroret pllakore formacione flishore te Oligocenit te poshtem.

Ne zone perendimore te rajonit eshte perhapur edhe flishi argjilo-alevroliti i Oligocenit te siperm, qe eshte nje formacion shume i bute krahasuar me dy formacionet e para, duke qene zona me te uleta ne krahasim me kreshtat e maleve qe ze formacioni karbonik.



Foto Nr 2. Pamje e depozitimeve te Eocenit

Prerja e depozitimeve te oligocenit te poshtem perbehet nga pako kalimtare mergelore, qe vendoset ne menyre te doradorshme e here here transgresive mbi depozitimet e Eocenit apo Kretakut te siperm, kur eshte transgresiv, me trashesi deri ne 55 m. Mbi to, ne menyre te qarte dhe pa pushim stratigrafik vendosen depozitimet flishore ritem holle argjilo-ranore. Mbi flishin ritem holle argjilo-ranore, vazhdon flishi me i eger ranor-argjilor me horizonte vithisese, te

perfaqesuara nga konglomerate dhe Olistrome. Pra ne menyre suksesive mbi to vendosen ranore masiv.

2.5. Te dhen ate shkurtra mbi llojin e mineralit.

I. Marrja dhe perpunimi i provave.

Per percaktimin e cilesise se gelqeroreve te objektit qe do te shfrytezohet jane marre disa prova, te cilat jane analizuar.

Keto shtresa jane perfaqesuese per gjithë rezervat e llogaritura. Provat e siperme jane analizuar edhe ne drejtim te treguesve te perberesve kimike dhe vetite e ndryshme fiziko-mekanike.

a) Perberja kimike

Nga ana kimike shtresat produktive te gelqeroreve kane cilesi te mire. Keshtu perqindja e CaO eshte 50-54%. Ndotsit si Fe₂O₃, P₂O₅ jane ne perqindje te paperfillshme, po ashtu dhe komponentet e sqfurit.

Lenda organike mungon ne shkemb, mungesa e ndotjeve i ben shtresat e gelqeroreve me veti te mira dekorative, kjo se nuk leshojne ne siperfaqen e lemuar hekurin, lende organike, sulfurore etj. Permbajtje e ulet e SiO₂ (1-1,8%) i bene gelqeroret lehtesisht te punueshme me mjete te thjeshta.

Tabela Nr 2 Treguesit cilesore te gelqerorit te objektit

CaO	Fe ₂ O ₃	MgO	Al ₂ O ₃	SiO ₂	HK
52.92%	1.65%	1.51%	0.29	1.82%	41.46%

b) Vetitet e ndryshme fiziko-mekanike.

Struktura e gelqeroreve

Shtresat e gelqeroreve produktive kane strukture pelitomorfe dhe kokrrizore. Struktura kokrrizore dhe brekçioze kane pako te trasha te gelqeroreve qe ndajne pakot produktive ndersa strukture pelitomorfe kane gelqeroret shtresore.

Çarshmeria e gelqeroreve.

Ne shtresat e gelqeroreve vihet re makroçarshmeri dhe mikroçarje. Makroçarshmeria pret disa shtresa ose dhe pako shtresash duke krijuar prerje me kende 70-90 grade me renien e shtresave. Keto çarje jane te mbushura me lende argjilore. Mikroçarshmeria nderthur shtresen ne plane te ndryshem. Ato me shkembin e fresket duken si te çimentuara, por me kalimin e kohes, shperbehen, duke keputur shtresen ne copa relativisht te medha 50 x 50 cm Ne disa raste keto çarje jane te mbushura me lende kalçiti

Mikroçarshmeria dhe makroçarshmeria kane rendesi per shfrytezimin e gelqeroreve, duke pasur çarshmeri te zhvilluar si shtresat e gelqeroreve produktive dhe pakot jo produktive qe i nbajne ato, shfrytezimi i tyre eshte me i lehte dhe me ekonomik duke krijuar kushte qe shfrytezimi te behet me mjete te mekanizuara pa perdorur lende eksplozive.

Treguesi i RQD nendrejtim te shtrirjes dhe renies se shtresave eshte 30-40% , çka do te thote se permasat e pllakave qe dalin nga shfrytezmi i shtresave jane te shkaterruara dhe e vetmja mundesi per tu perdorur si inerte .

Rezistenca e shkembit

Rezistenca eshte nje veti mekanike qe ka te beje me fortesine dhe qendrueshmerine e tij, ndaj ngarkeses ne ndertime, por dhe ne perdorime te tjera te tij. Gelqeroret grupohen ne shtresa me qendrueshmeri mesatare dhe fortesi mesatare.

Pesha vellimore e evidentuar eshte perfaqesuese per shkembin primar te pashkriferuar, ne rastin kur gelqeroret do te shfrytezohen pra do te copetohen, pesha volumore e tyre do te jete 2-2,1 ton/m³.

- Analizat fiziko mekanike te kampineve te studjuara tregojne se keta gelqerore kane karakteristikat e meposhteme :
 - ✓ Rezistenca ne shtypje ne gjendje natyrale per 18 kampione te analizuar, rezulton nga 750 kg/cm² ne 880 kg/cm².
 - ✓ Pesha vellimore, 2.60 gr/cm³.
 - ✓ Pesha specifike , 2.7 gr/cm³.
 - ✓ Pesha e volumit te skeletit 2.695 gr/cm³
 - ✓ Qendrueshmeria terheqje, 86.4 kg/cm²

Shtresat e gelqerorit porcelanor priten dhe skaliten me lehtesi duke lejuar, ne kete menyre, te perfitohen pllaka me dimensione dhe trashesi qe i pergjigjen kryesisht tregut te jashtem

2.6.Kushtet hidrogeologjike te vendburimit.

Ky VB per nga pikpamja hirogeologjike ndodhet ne kushte shume te mira. Kjo dhe per faktin se terreni eshte mjaft i eroduar dhe i aksidentuar. Ne zonen e objekti ne kuota te poshteme ne buze te lumit Osum ka dalje te konsiderueshme uji ne formen e burimeve te ujrash te pijshem. Ne kohen me lageshtire dhe rreshje meqenese argjilat thithin mjaft lageshti dhe per pasoje rritin volumin duke u bymyer e duke krijuar premisa per rreshqitje masive. Per kete arsye eshte mire qe te menjanohet puna ne kohe lageshtire.

2.7 Kushtet tekniko-minerare

Objekti ka kushte te pershtateshme tekniko minerare per shfrytezimin me qiell te hapur. Qendrueshmeria e formacioneve, qe ndertojne vendburimin eshte e tille qe favorizon rrezimin e tyre pa pasur nevojte per perdorimine lendes plasese . Mbulesa e vendburimit eshte e hequr keto dhjete vjet aktivitetet minerar dhe eshte sistemuar brenda konturit te karrieres

2.8 Tektonike.

Kushtet tektonike te VB-it ne pergjithesi jane te mira. Nuk vihen re spostime te dukshme tektonike qe te sjellin probleme qofte ne kerkim-zbulimin e metejshem te tij, por ajo qe eshte me

e rendesishme nuk sjellin asnje problem gjate procesit te shfrytezimit. Ky element gjeologjik perben favor ne shfrytezimin e rezervave te objektit.

Variantet e hapjes se vendburimit, argumentimi dhe zgjedhja e menyres se hapjes se vendburimit.

Vendburimi do te hapet nga rruga ekzistuese qe pershkon vendburimin ne pjesen veriore te tij. Punimet e hapjes do te kryen vitin e pare te aktivitetit.

Ne studimin e varianteve te hapjes se vendburimit jane mare ne konsiderate :

Kuota e poshtem e rruges ekzistuese +100m

Kuota e siperme e zones se shfrytezimit +280m

Parametrat gjeometrike te zones se shfrytezimit

Shperndarjen e rezervave te nxjerreshme ne shkalle ne raport me sasine e pergjitheshme te rezervave

Pjeresia mesatare e siperfaqes se vendburimit

Mbas marjes ne konsiderate te faktoreve te mesiperme eshte bere studimi i varianteve te hapjes se vendburimit dhe eshte konkluduar se hapja do te behet nga rruga ekzistues ne kuotën +210m dhe te vazhdojë deri ne kuotën +260m.

Sistemi i shfrytezimit treguesit tekniko-ekonomike te tyre.

Ne zgjedhjen e sistemit te shfrytezimit jane mare parasysh faktoret e meposhtem:

Menyra e ngarkimit dhe transportit te sterilit

Menyra e ngarkimit dhe transportit te gurit gelqeror ne brendesi te karrieres dhe jashte saj

Ngarkimi i gurit gelqeror ne te gjitha sheshet e karrieres parshikohet te kryhet me eskavator me kove 2 m³

Bazuar sa me siper sistemi i shfrytezimit projektuar eshte i thjeshte me transport te prodhimit ne distance 360m , deri ne impjantin e thyerje fraksionimit ndertuar ne teritorin e karrieres.

Elementet e sistemit te shfrytezimit qe parashikohet te perdoret ne kete objekt jane

Lartesia e shkalles se karrieres eshte

10m

Gjeresia e sheshit te punes nga

8-12 m ne 20-40-50m

Kendi i skarpates se shkalles

73°

Kendi i sharjes se skarpates se shkalles

55°

Gjeresia e shesheve perfundimtare te shkalleve

4 m

Kapaciteti ditor gur gelqeror rreth

80m³

Ngarkimi dhe transporti i mekanizuar;

Rezimi i i gur gelqeror do te behet me lendes plasese te vendosur ne bira sonde

Rradha dhe drejtimi i shfrytezimit

a) Rradha dhe drejtimi i shfrytezimit

shfrytezimi i vendburimit do te behet nga larte me shkalle te pare ne kuotën + 250 deri +260 duke u ulur deri ne shkallen fundore me kuote =210.

Drejtimi shfrytezimit do te jete nga lindja ne perendim

Orjentimi i pergjithshem i shkalleve do te jete sipas izohipseve te terenit (shih planimetrine e karrieres ne gjendjen perfundimtare)

Per realizimine sasise se prodhimit te parashikuar ne projektin e shfrytezimit te ketij objekti eshte parashikuar qe shfrytezimi te kryhet ne dy shkalle .

Per krijimin e kushteve per nje pune normale ne karriere eshte parashikuar qe ne vitin e pare te behen hapja e karrieres dhe ndertimi objekteve ndihmese.

b) Elementet gjeometrike te karrieres ne gjandje perfundimtare

Duke pasur parasysh pozicionin gjeografik te karrieres, relievin dhe parametrat gjeometrike te shkalleve, karriera do te kete formen e nje amfiteatri , me parametrat e me poshtem.

Tabela: Parmetrat e karrieres pas 25 vitesh dhe ne fund te shfrytezimit

Nr	Emertimi	Njesia	Vlera
1	Thellesia e vertikale e karrieres,	m	50
2	Numuri i shkalleve	Nr	5
3	Gjatesia e karrieres ne plan ne pjese e siperme te saj do te jete,	m	172
4	Gjatesia ne sheshin e poshtem te karrieres,	m	243
5	Thellesia e karrieres ne sheshin fundor te saj rreth	m	97
6	Kendi i shuarjes se shkalleve ne varesi te shtrirjes se karrieres eshte	Grade	55
7	Lartesia e shkalles	m	10
8	Orientimi i transheve te hyrjes eshte nga pjesa perendimore ne drejtim te lindjes		P-L
10	Siperfaqja e karrieres ne plan se bashku me transhete e hyrjeve	Km ²	0.0305

Vleresimit të Ndikimit në Mjedis

Studimi i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e mjedisit ku do te shfrytezohet per germimin dhe nxjerrjen e mineralit, përfshirë kushtet fizike, të burimeve ujore, biologjike, atmosferike, burimet kulturore dhe gjendjen social-ekonomike.

Në procesin studimor të VNM përdoren informacioni dhe të dhënat ekzistuese të përfituara rishtas mbi kushtet e mjedisit te sheshit qe do te shfrytezohet, së bashku me standardet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar impaktet potenciale mjedisore dhe sociale të fasiliteve të propozuara.

Kërkesat e studimit të Vleresimit të Ndikimit në Mjedis

Impaktet potenciale mjedisore të shqyrtuara dhe të analizuar në procesin e VNM përfshijnë impaktet ndaj cilësisë së ujit, burimet tokësore dhe ujore, cilesine e ajrit, tokes, mjedisit biologjik dhe situatën social-ekonomike dhe kulturore. Burimet e vlerësuara social-kulturore përfshijnë punësimin, përdorimin e tokës, peshkimin, lundrimin lokal, transportin rrugor dhe shërbimet e komunitetit vendas.

VNM përvijon gjithashtu edhe masat zbutëse për t'u zbatuar për të ndihmuar parandalimin ose minimizimin e ndikimeve negative, siç mund të jetë e praktikueshme, të impakteve mjedisore dhe sociale të projektit të propozuar. Këto raportohen në detaje në planin e menaxhimit të mjedisit (PMM), i cili është pjesë e raportit. VNM-ja përbëhet nga tërësia e procedurave të shfrytëzimit të burimit, rehabilitimit dhe monitorimit.

Plani raporton edhe veprimet që nevojiten për t'i zbatuar këto masa. Për më tepër, VNM-ja trajton menaxhimin specifik të mjedisit dhe planet e strategjitë monitoruese dhe identifikon çdo kërkesë dhe afat të domosdoshëm të kerkuar.

Korniza kryesore e kuadrit ligjor për përgatitjen e këtij Raporti të thelluar të VNM:

-Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit"

-Ligji Nr.10 440, datë 7.7. 2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".

Metodologjia e hartimit të këtij raporti të VNM është hartuar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Vendimit të KM Nr. 13, datë 04.01.2013 "Për Vlerësimin e Ndikimit

Metoda e përgatitjes së VNM

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e raportit të VNM-së u bazua në:

Zbatimin e politikave, rregullave, udhëzimeve operacionale dhe masave organizative institucionale ekzistuese në Shqipëri për të zgjidhur dhe lehtësuar impaktet shoqërore dhe mjedisore të studimit.

Vlerësimin e përputhshmerisë së parimeve baze të rregullave të shtetit Shqiptarë duke identifikuar boshllëqet dhe duke paraqitur rekomandime për t'i zgjidhur ato.

Identifikimin dhe vlerësimin e natyrës dhe magnitudës së impakteve mjedisore dhe sociale, duke përfshirë ndikimet sociale dhe mjedisore për të përzgjedhur projektet për implementimin dhe për të përcaktuar nivelin e studimeve/vlerësimeve sociale dhe mjedisore që kerkohen;

Sugjerimet mbi modalitetet për përgatitjen e masave lehtësuese në lidhje me zonën ku do zbatohet projekti.

Bashkpunimin me Institucionet përgjegjëse në nivelin qendror është ashtu dhe në atë rajonal, si dhe me specialist të mjedisit, që do të jete përgjegjës për monitorimin e këtij studimi dhe të vlerësimeve të tjera mjedisore specifike si dhe bashkpunimi me njesitë e qeverisjes vendore për t'iu përmbajtur kërkesave të parashtruara në Leje Mjedisore.

Për hartimin e raportit të VNM, porositesitë vuri në dispozicion të hartuesve të raportit materialin teknik të disponueshëm, juridik e projekt-shfrytëzimin.

Kërkesat sociale

Duke pasur parasysh gjendjen social-ekonomike në rajon, kjo veprimtari do të gjenerojë përfitime të rëndësishme për zonën dhe më gjerë, për rajonin. Gjatë periudhës disa vjeçare të shfrytëzimit të burimit llogaritet të punësohen disa dhjetëra punonjës nga zonat përreth.

Hapja dhe shfrytëzimi i karreres do të gjenerojë një veprimtari të nxitur të rëndësishëm në lidhje me përfitimin ekonomik, punësim zhvillim, rritje ekonomike.

Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimtarie apo projekti te caktuar. Ne nje situatë normale, ky process aplikohet perpara se te merret vendimi dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Po ashtu ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Gjithashtu VNM ka per qellim:

- Te jape informacion per vendimmarresit per pasojat mjedisore te studimit te propozuar.
- Te promovojë zhvillimin miqësor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis
- Reduktimin e ndikimeve ne mjedis nepermjet nje zhvillim te qendrueshem me mjedisin. Keto ndikime jane mjaft komplekse, me te medha ne zonen e zbatimit te projektit dhe per me teper shtrijne pasojat e tyre me shume se 25 vjet qe perkon me afatin e lejes minerare te shfrytezimit. Si rezultat, VNM eshte studimi baze per vendimarrjen per nje zhvillim te propozuar.

Ne aspektin nderkombetar, roli i VNM eshte njohur ne Principin e 17 te Deklarates per mjedisin dhe Zhvillimin.

VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane subjekt i nje vendimmarrje te nje autoriteti kombetar.

Qellimi dhe objektivat e VNM mund te ndahen ne dy kategori.

Qellimi i pare, drejtperdrejte, eshte te informoje organet vendimarrese duke identifikuar ndikimet ne mjedis mbi rreziqet dhe perfitimet e projektit te propozuar.

Qellimi i dyte, afatgjate i VNM eshte te promovojë zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk demtojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien dhe stilin e jetes te komunitetit qe lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet dhe te flores e faunes se zones.

Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM:

- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence.
- Identifikon masat tekniko-organizative per zvogelimin e ndikimeve te mundshme ne mjedis te projektit te propozuar
- Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut.
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit.
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve.
- Permireson aspektet sociale-ekonomike

Kuadri ligjor kombetar

Sa me siper, ky Raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte mbështetur ne legjislacionin mjedisor dhe ka per qellim qe te identifikojë, parashikojë dhe parandalojë ndikimin e këtij aktiviteti ne mjedis.

Kuadri ligjor për VNM-ne sigurohet ne menyre te drejtperdrejte nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri Ligji Per mbrojtjen e mjedisit dhe Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. Keto ligje se fundmi jane perafruar plotesisht me ligjet e Bashkimit Europian per mbrojtjen e mjedisit dhe Vlersimin e Ndikimit ne Mjedis.

Bazuar ne Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 Per lejet e mjedisit, ne Aneksin Nr.1 ,ky projekt klasifikohet ne listen e aktiviteteve qe duhet te paisen me lejemjedisore te tipit B per te gjitha instalimet.

Sipas Ligjit Nr. 10440, date 07.04.2011 "Per VNM", shtojca 1 dhe VKM. Nr. 13, date 4.01.2013 "Për proceduren e VNM-se", ky projekt duhet ti nenshtrohet procedures se miratimit te VNM se thelluar(Shtojca 1, pika 19).

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton tipin dhe shkallen e projekteve apo veprimtarive qe kerkojne VNM para implementimit. Kategorite e VNMve jane:

Baza ligjor

- Ligji Nr 10431 datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"
- Ligji Nr 10440 datë 07.07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis"
- Ligj Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit"
- Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit"
- Ligji Nr.10 081, datë 23.02.2009 "Për Licencat, autorizimet dhe lejet nëRepublikën e Shqipërisë".
- Ligj Nr.9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit"
- Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura". I ndryshuar me:-Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008
- Vendim Nr.1189, Datë 18.11.2009 "Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit"
- Vendimi Nr.247, datë 30.04.2014 "Për tërheqjen e mendimit te publikut në vendimmarrje për mjedisin".
- Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 "Per menaxhimin e zhurmave"
- Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 "Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis"
- Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"
- Vendim Nr. 452, datë 11.7.2012 "Për lendfilllet e mbetjeve"
- Vendim Nr. 99, datë 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve"
- Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse"
- Vendim Nr. 538 dt.26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL

- dhe disa rregulla te tjera”
- Vendim Nr. 13, date 04.01.2013 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”
 - Vendim i Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL.
 - Vendim Nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen e zonave te mbrojtura monument natyror”

Metodologjia e Vleresimit

Ky projekt pergatitet me kerkese te investitorit, subjekti “PAJO 2010” Sh.p.k. Permbledhja jo teknike dhe VNM , jane bere nga e njejta studio qe ka hartuar projektin tekniko-ekonomik Dhe te shfrytezimit te vendburimit.

Tabela: 1: Kriteret e klasifikimit per procedurat shqiptare te VNM-se

Kategoria sipas Legjislacionit Shqiptar	Procedura qe Duhet Ndjekur (Duke plotesuar Standartet Shqiptare)
Aneksi i Ligjit 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisi	Sipas kerkesave te ligjit Nr 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, Shtojca 1 per Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C ky aktivitet klasifikohet per paisje me leje mjedisore te tipit B.
Shtojca 1 dhe 2, Ligji Nr.10440, date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”	-Pergatitja e procedures se raportit te thelluar te VNM-se, sipas klasifikimit ne shtojcen Nr. 1 pika 19. -Organizimi i konsultimit me publikun, sipas VKM Nr. 13, date 04.01.2013.

Rezultatet e priteshme.

Investimet qe do te kryhen ne vite.

Shoqeria per venien ne pune te ketij objekti do te investoje rreth **60 000 000 leke**

Investimet ne rehabilitim

Siperfaqja e zone se publikuar qe kerkohet per marrjen e lejes Mjedisore per mineralin ndertimor gur gelqeror eshte **0.0305km²**.

Per periudhen prej 25 vitesh siperfaqja qe do te preket nga shfrytezimi do te jentererth 3.05 ha: Ne perfundim te shfrytezimit te rezervave do te behet mbyllja e aktivitetit. Do te behen punimet per mbylljen e karieres dhe reabilitimin ambjental dhe parashikohet te kryen keto punime:

- Hapja e rrugëve lidhese te shkalleve
- Sistemimi i skarpateve dhe krehja e tyre nga blloqet dhe coperat e dala.
- Mbjellje bari e shkuresh.
- Sistemim dhe punime siguruese te shesheve te shkalleve te shfrytezuara.

Siperfaqja e lejes minerare te subjektit “PAJO 2010” shpk, zona minerare 376/5 eshte 0.0305km² ose 3.05 hektare dhe me nje prodhim deri 20 000 m³/vit,

Plani perfundimtar i mbylljes dhe rehabilitimit mjedisor pas perfundimit te aktivitetit minerar te shfrytezimit te mineralit gelqerorit ne lejen minerare nr 376/5 objekti "KANIZBALT " rrethi BERAT hartohet ne zbatim te Udhezimit Nr 718, date 03.10.2011 " Per menyren e vleresimit te garancive financiare te lejeve minerare"

Objekti miratuar nga METE me nr. 376/5. Perbehet nga siperfaqe 0.0305km2

Ne llogaritjet e kryera me poshte jane bere llogaritjet perkatese per realizimin e te gjitha proceseve perkatese te parashikuar te rehabilitimit.

1-Shpenzimet per mbylljen dhe reabilitimin e 1 ha kariere per pjesen e shfrytezuar me siperfaqe eshte
= **322 750 leke/ha**

2-Shpenzimet per çmontimin, ngarkim dhe transportimin e impiantit eshte
= **240379 leke**

Percaktimi i shpenzimet te investimeve per reabilitimin e karieres .

Siperfaqja qe do te preket nga shfrytezimi dhe qe do te rehabilitohet eshte

7.4 hektare:

-
- | | | | |
|----|--------------------------------------|---------------------------------|----------------|
| 1. | Rehabilitim kariere | 3.05 hektare x 322750lek/hektar | = 984387.5leke |
| 2. | Çmontim impiantit thyerje fraksionim | | = 240 379leke |
-

Shuma totale per mbyllje rehabilitim te objektit = **1224766.5 leke**

Garancia vjetore e mjedisit = **48990leke**

Shuma e me siperme eshte parashikuar ne shpenzimet e subjektit dhe eshte marre ne konsiderate ne llogaritje e te ardhurave dhe shpenzimeve me CF.

Cilësia e ajrit

Ne zonen e marre per studim ajrit eshte i paster. Ne kete teritor nuk ka objekte industrial dhe banimi qe shkarkojne ne atmosfere gaze te demsheme dhe pluhur qe te prishet cilesia e ajrit. Objekti pershkohet nga nje rruge makine e me levizje te kufizuar te mjeteve dhe si rrjedhoje nuk do te kete shkarkime ne ajet te gazeve ose krijim pluhuri.

Zhurmat

Lidhur me zhurmat, në zonën e studimit nuk ka ndonjë informacion në lidhje me nivelet e ndotjes së ambientit. Zhurma nuk është shqetësimi kryesor në zonën që rrethon kete zone rurale drejtpërdrejt. Aty nuk ka burime emetimi të ndjeshëm zhurmash. Nivelet e zhurmës brenda fshatrave janë tipike për çdo zonë rurale te nivelit te fshatrave dhe janë të lidhura kryesisht me trafikun e automjeteve qe eshte ne nivel minimal. Megjithatë rekomandohet që nivelet e zhurmës duhet të monitorohen gjatë ndertimit por edhe gjate operimit.

Mjedisi biologjik i rajonit

Zonat e Mbrojtura

Aktiviteti m inerar shfrytezim guri gelqeror me kariere nuk prek zona te mbrojtura. Ne kete teritor nuk ka monomente kulture, zona arkeologjike, parqe kombetare ose rajonale me status

mbrojtjes, nuk ndodhen gjeomonumente, objekte te rendesishme te ndertuara nga njeriu, drure dhe gjallesa te mbrojtura me ligj si specie ne rrezik.etj.

Flora dhe fauna

Flora

Shtirirja vertikale e zonës, pjerrësia, variacioni pedologjik nga formacione gjysëm shkëmbore shoqërohet me diversitet të konsiderueshëm biologjik. Ato formojnë një bimësi të qendrueshme Shpatet janë të pjerrta, me rrëpira shkëmbore, guvakarstike me bimësi sdhkurre natyrore, kryesisht shkurre te bimesise mesdhetare barishte dellinje, shkoze, etj dhe përroska të tipit guror. Shpesh shpatet janë pothuajse të zhveshura plotësisht nga bimësia drunore, por të pasura me bimësi barishtore. Në të janë zhvilluar shumë proceset e karstit ndaj ka shumë shkrepë, hinka e dolina karstike dhe stera më të shpeshta në fundin apo rrezen e shpateve të tyre që e vështirsojnë kalimin drejt kurrizit të malit. Në pjesët më të ulëta gjenden shkurre me gjelbërim të përherëshëm, si mare, frasher, dëllenja, shkoza, ferra, etj.

Vazhdimisht shkurret janë trajtuar si pa dobi ekonomike. Kjo lidhje me konceptin e gabuar se çfarë japin ato drejt për drejt për të rregulluar mirëqënien pa i vlerësuar për rolin e tyre të pazëvendësueshem në pasurimin e ajrit me oksigjen për mbrojtjen e mjedisit e të tokës nga degradimi e shkretëzimi për faunën e pasur në dobi të natyrës dhe të njeriut për rritjen e lagështisë së ajrit për lëvizjen e ngadaltë e pastrimin e ujit në sipërfaqe e brendësi të tokës një element shumë jetësor për qeniet e gjalla.

Ndër përdorimet kryesore të shkurreve do të theksonim: bimët mjekësore sidomos frutat e disa shkurreve: kokrrat e dëllinjës dhe të murrizit, gjethet e dafinës ndërsa frutat e marës për raki. Lulëzimi i bimësisë së katit të shkurreve ka ndihmuar shumë zhvillimin e apikulturës. Mjalti i kësaj zone njihet si ndër më cilësorët dhe më kurativët në vendin tonë. Ashtu si edhe tek kati i shkurreve edhe ketu kjo është në varësi të kundërdrejtimin të shpateve.

kjo ndodh pasi ato kanë pak kërkesa ndaj tipit apo pasurisë me lëndë minerale të tokës. Të pakta janë edhe kërkesat e këtyre drurëve ndaj lagështisë. Pikërisht ky është faktori që ka kushtëzuar zhvillimin e mirë të bimësisë barishtore brenda pyllit dhe në lëndinat e livadhet me shtirirje të dukshme. Edhe këtu kjo bimësi është e pashur në lloje dhe përdoret shumë si kullotë për blegtorinë dhe bletët në stinën e pranverës e fillimit të verës. Që prej më shumë se 7-8 dhjetëvjeçarësh sipërfaqja e tij ka ardhur duke u zvogëluar. Kjo është prirja edhe për të ardhmen pasi është rritur shumë kërkesa për dru zjarri lëndë ndërtimi bazë ushqimore të gjelbër për blegtorinë në stinën e dimrit për zonat e larta etj.tani rezulton sipërfaqe të kufizuara të këtij pylli pranë fshatrave. Kati i Ahut vendoset mbi atë të dushkut dhe shënon kufirin më të sipërm të bimësisë natyrore drunore. Ai përbëhet nga drurët e Ahut dhe të Pishës të cilët ndodhen në teritore kryesisht gëlqerore dhe në lartësi mbi 1200-1500 m. Kufiri më i sipërm arrin deri në lartësinë 1700-1800 m mbi nivelin e detit. Shpesh terreni është shkëmbor shpatet kanë pjerrësi mesatare të lartë dhe mbulesa e tokës ka trashësi të vogël. Klima është mesdhetare malore ku dëborë është dukuri e zakonshme gjatë stinës së dimrit deri në mesin apo fundin e pranverës. Vërehet se nuk ka një ndarje të qartë as midis shtirirjes së pyllit të ahut dhe atij të pishës. Larmia e bimëve barishtore krejtësisht larg kimikateve, klima e shëndetshme dhe uji i pastër i burimeve e bëjnë prodhimin cilësor plotësisht biologjik.

Ky peizazh nuk është monument kulturë. Vazhdimisht shkurret janë trajtuar si pa dobi ekonomike. Sheshet e përzgjedhur në përgjithësi janë të zhveshur dhe jo të mbuluar nga bimë të larta, janë sheshe të zëna nga shkurre apo nga barishte. Nuk janë konstatuar florë dhe faun të specieve të llojit të vecantë apo në rrezik (mbështetur në Red Book të Shqipërisë 1995). Në këto zona prania e bimeve të larta me vlerë drusore mungon.

Fauna

Zona, për shkak të kushteve të vecanta të regjimit atmosferik, klimatik e gjeologjik, është e pasur në bimësi dhe në faunë. Fauna dhe flora formojnë një sistem ekologjik tepër kreativ dhe me vlera mjedisore. Fauna është karakteristike e faunës që jeton në zonën e pyjeve të dushkut, ahut dhe bimëve të tjera gjethegjërë. Zona ka edhe faunë të egër të larmishme por si kudo në vendin tonë ajo është dëmtuar shumë nga gjuetija pa kriter depërtimi i njeriut, nga përdorimi i kimikateve, etj. Ajo tashmë ruhet më mirë vetëm në zonat e mbrojtura. Zona e studiuar për shfrytëzim guri gelqeor lidhet e komunikon si habitat, mjedis ushqimor, e migrues, kalimtar. Ndër llojet e botës shtazore përmendim kafshët si, Lepuri (*Lepus Europeus*), Kunadhja (*Martes Foina*), Dhelpra (*Vulpus- Vulpus*), Shqiponja, Thëllëza, Pellumbi, arabeli, gush kuqi, trumcaku, trishtili, mellenja, grifsha, etj.

Zona është e pasur me shpendë të tilla si: Thëllëza e malit (*Predix-Predix*), Mëllënja (gjinia *Turdiae*), Pëllumbi i egër *Shpatorja*, grifsha, arabeli, gush kuqi, trumcaku, trishtili, etj.

Nga zvarraniket takoen ardhuca e shkëmbinjve, zhapiku, neperka, etj.

Gjithashtu kjo zone është e pasur me kerpudha, inskte të ndryshme, etj

Theksojme se mungojnë bimët e ujet, ato nuk kanë kushte jetese sepse nuk liqene, ujdhesa.

VLERESIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS DHE MASAT PARANDALUESE GJATE SHFRYTEZIMIT TE OBJEKTIT MINERAR DHE PAS MBYLLJES SE AKTIVITETIT.

Te pergjithshme

Vepri i kryesor që propozohet të kryhet ka përmasa relativisht të kufizuara qoftë të karakterit të investimeve ashtu edhe të outputeve që do të japë gjatë shfrytëzimit të saj. Pavaresisht nga permasat e projektit është e domosdoshme të analizohen ndikimet në mjedis për mbrojtjen e flores dhe të faunës në hartimin e projektit, shqyrtimin dhe miratimin e tij, para fillimit të punimeve të germimit dhe më tej gjatë shfrytëzimit deri në mbylljen e aktivitetit.

Vlerësimi i ndikimeve në mjedis paraqet një analizë të hollësishme të ndikimeve të mundshme negative dhe pozitive duke specifikuar edhe masat zbutëse që duhet të aplikohen për të eliminuar apo për të minimizuar sado pak ndikimet negative në mjedis.

Kjo analizë kryhet duke u bazuar në projektin e VNM, konsultimit me publikun, identifikimi i pasurisë natyrore të rajonit dhe permasave të projektit.

Ndikimet në mjedis të këtij raporti të përmbledhur vlerësohen për fazën paraprake të konsultimit me publikun dhe me pas plotësohen me informacione dhe problematika të hasura gjatë rrugës për hartimin e raportit të thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Ndikimet në mjedis mund të grupohen si më poshtë:

-Kimike-Fizike të cilat lidhen me ndikimet mbi burimet natyrore si edhe proceset e degradimit

- fizik te mjedisit vete.
- Biologjike-Ekologjike përfshirë burimet natyrore, ruajtjen e biodiversitetit, ndikimin mbi jetën e gjalle te ndotjes se biospheres, etj.
 - Sociologjike te lidhura me komunitetin apo edhe individët e veçante, ndikimin mbi trashëgiminë kulturore dhe progresin e supozuar.
 - Ekonomike-Makroekonomike te cilat marrin parasysh ndikimet e përkohshme apo te përhershme shkaktuar për shkak te realizimit te projektit.

Vleresim i impakteve kryesore ne mjedis

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe VKM Nr. 13, date 04.01.2013 "Per vleresimin e ndikimit nemjedis" dhe ka si synim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te uptojmembrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.:

Sa me siper vleresimi i ndikimeve ne mjedis do te vleresoje:

- Ndikimet ne ajer
- Ndikimet ne ujera
- Ndikimet ne toke
- Ndikimet ne biodiversitet (mjedisi biologjik)
- Ndikimet ne mjedisin social-ekonomik
- Ndikimet qe shkaktojne ndryshimet klimatik

**Ndikimet ne ajer, cilesia e ajrit,
zhurmat, vibrimet, peizazhi.**

Impakti:

Me projekt hapja e karieres do te behet nga rruga e kzistuese ne kuoten +490. Punimet e hapjes do te ndertohen ne teritorin e lejes minerare me gjatesi 600m.

Hapja dhe perdorimi i kesaj rruge do te shkaktoje ndikim ne cilesine e ajrit, do te ngrihen pluhura pergjate trasese se rruges dhe ne sheshin e punimeve ne rast se nuk aplikohet lagia me uje gjate sezonit me thatesire. Shkarkimet e gazeve te mjeteve motorike do te jene burime te shkarkimeve te gazeve te demshme per ajrin. Perdorimi i lendeve plasese do te jete nje burim tjetër i pluhurit dhe lendeve te tjera te ngurta ne ajer. Zhurmat jane normale per nje aktivitet te tille, por qe nuk do te jene shqetesuese per zonat e banuara.

Kryesisht zhurmat shkaktohen nga shperthimet e masivit te shkembit, nga transporti, germimet e tokes shkembore, etj. Vibrimet do te jene prezente vetem gjate procesit te perdorimit te lendeve plasese per shkeputjen e masivit.

Gjate punimeve do te preket peizazhi i zones qe do te shfrytezohet, nga germimet dhe humbja e bimesise, do te ket ndryshim te relievit, heqja e shtreses humusit, depozitimi i sterileve, hapja e rrugeve te reja, ndertimet e perkohshem te objekteve dhe magazinimi i materialeve ndertimore do te kene ndikim ne mjedis. Sheshi i parkimit dhe makinerite gjithashtu do te kene efekt ne peizazhin e zones.

Masa parandaluese:

Aplikimi i lagies se trasese dhe kantierit me uje gjate sezonit me thatesire per te reduktuar pluhurat. Kufizimi i orarit te punes vetem gjate dites per te reduktuar zhurmat. Perdorimi i mjeteve bashkekohore dhe me kriter e brenda kushteve teknike.

Perdorimi i mjeteve dhe materialeve cilesore e eficiente. Monitorim i cilesise se ajrit gjate fazes se punimeve. Menaxhim i sterileve te depozituara dhe te sheshit te grumbullimit te shtreses se humusit.

Ky projekt ndikon ne mjedisin biologjik te zones. Kete efekt mund ta reduktoje vetem zbatimi i nje projekti rehabilitimi te detajuar te siperfaqes se shfrytezuar te karrieres.

**Ndikimet ne ujera,ujerat siperfaqesore,
ujerat nentokesore.**

Impakti:

Nga zbatimi i ketij projekti do te kete ndikime minimale ne ujera siperfaqesore dhe nentokesore perfaktin se ne kete teritor nuk ka ujra siperfaqesore dhe nentokesore qe preken dukshem nga zbatimi projektit. Ndikimi ne ujerat siperfaqesore e nentokesore do te vije si rrjedhoje e punimeve ne siperfaqe por edhe nentoke ne faza te mevoneshme.

Masa parandaluese:

Te orientohen ujerat e shiut ne drejtim te kolektoret kryesor, per te parandaluar vershimin e tyre ne zonat e shfrytezimit per tu mbrojtur nga erozioni, formimin e pellgjeve me uji ne mjedisin e karrieres nepermjet ndertimit te kunetave ne skarpaten e karrieres. Te orientohen ujerat

nentokesore qe mund te dalin ne siperfaqe gjate germimeve, duke mos lejuar rrjedhjen e tyre ne menyre te pakontrolluar ne mjedisin e zones.

Nese do te shihet e nevojshme, te ndertohet edhe nje vaske dekantimi e filtrimi te ujit te kantierit. Makinerite te mos shkarkojne substanca te demshme ne mjedisin ujqor te zones.

Ndikimet ne toke, relievi, siperfaqja, perberja e struktures se tokes, nentoka.

Impakti:

Nga zbatimi i ketij projekti ndikimet mbi toke do te jene minimale, zhvillimi i ketij aktiviteti kerkon nje hapesine relativisht te madhe ne toke pasi kerkon nje shtrirje e siperfaqe, ne total prej 3.05 Ha por nenkuptohet qe nuk do te shfrytezohet e gjitha. Kjo toke e cila eshte pyjore, do te merret ne perdorim nga subjekti qe ka fituar tenderin e shfrytezimit te ketij objekti dhe duhet te rehabilitohet ne perfundim te shfrytezimit. Perdorimi i tokes konsiston ne shfrytezimin per 25 vjet te saj si shesh i punimeve te minieres, por edhe ne zenien e saje ndonese ne siperfaqe te vogla per depozitimin e perkohshem te shtreses se humusit dhe depozitimin e sterileve. Gjithashtu duhen kryer edhe punime mbrojtese per sheshet e depozitimit te inerteve, si dhe depozitimit e ruajtjes se inerteve.

Pritet nje ndryshim i struktures dhe perberjes se siperfaqes se tokes gjate shfrytezimit dhe pas punimeve te rehabilitimit te siperfaqeve te demtuara. Si rrjedhoje e punimeve te shfrytezimit, do te kemi edhe ndryshim te relievit.

Masa parandaluese:

Masat parandaluese do te ishin te nevojshme per reduktimin e impaktit mbi toke te ketij projekti. Rekomandojme ndertimin e pritave me mure guri, ose gjerdhe prej druri, ose me rrjete teli e bimesi autoktone. Rehabilitimi i siperfaqeve sa me shpejt te jete e mundur per te mos humbur siperfaqe toke. Ruajtja e humusit per te rehabilituar siperfaqet e demtuara, si te skarpateve te rruges dhe te shkalleve te shfrytezimit.

Sistemimi dhe rehabilitimi nepermjet perdorimit te sterileve per mbushjen e shkalleve dhe shesheve pas perfundimit te shfrytezimit te kariertes. Mbjellje e bimesise autoktone per te ruajtur strukturen dhe perberjen natyrale te tokes.

Ndikimet ne biodiversitet,Flora dhe fauna

Impakti:

Ndikimi kryesor dhe me i rendesishem ne mjedisin biologjik eshte gjate fazes se punimeve per hapjen dhe shfrytezimin e minieres. Nga zbatimi i ketij projekti qe ne total perfshine nje siperfaqe prej rreth 3.05 ha, pritet nje efekt domethenes ne demtimin e bimesise se zones, ndonese nuk dallohet si zone me bimesi te larte por kryesisht ate shkurre e barishtore. Demtimi i siperfaqes se tokes dhe i shtreses bimore te cilat sherbejne si habitat per nje sere gjallesash do te ndikonte edhe ne largimin e faunes se zones. Kryesisht kafshet e egra, zogjte dhe insektet e zvarraniket.

Masa parandaluese:

Rehabilitimi sa me pare i skarpatave dhe siperfaqeve pyjore te demtuara dhe investimi ne ndertimin e pritave per reduktimin e erozionit. Zbatimi i projektit te rehabilitimit sipas preventivit te detajuar te punimeve rehabilituese dhe monitorimi i ecurise se ketij procesi ne vazhdimesi. Mirembajtje dhe monitorim te vazhdueshem te terrenit problematik edhe nga erozioni natyror ne segmente te caktuara. Mbjellja e bimesise autoktone dhe sipas skemes se projektuar per te ndikuar ndjeshem ne uljen e erozionit dhe ne ruajtjen e identitetit te bimesise se zones. Si rrjedhoje edhe rikthimin e faunes autoktone te larguar perkohesisht.

Ndikimet ne mjedisin social-ekonomik, mjedisi social-kulturor dhe ekonomik, perdorimit tokes, perdorimi i burimeve ujore.

Impakti:

Ndikimi ne mjedisin social-kulturor e ekonomik nga faza e zbatimit te punimeve te shfrytezimit te mineraleve, vleresohet te jete pozitive. Kjo per shkak te nivelit te ulet ekonomik te zones dhe rritjes se punesimit nga projekti shfrytezimit, por edhe te tradites se zones, banoret e te ciles kane punuar prej vitesh ne miniera. Investitori do te kryeje edhe disa punime te tjera si hapje rruge dhe mirembajtje te rruges ekzistuese.

Gjetja e objekteve arkeologjike gjate punimeve do te ndryshonte rrjedhen e punimeve, megjithese nga instituti perkates nuk identifikohen te tilla.

Investim ndikon ne zhvillimin ekonomik e social-kulturor te zones.

Perdorimi i tokes aktualisht eshte per blegtori, nuk perfshihen toka bujqesore. Persa i perkete burimeve ujore, nuk perdoren per kete veprimtari. Nga burimet e zones, do te krijohet mundesia e furnizimit me uje per plotesimin e nevojave vetiake te punonjesve dhe te ambjenteve te punes.

Masa parandaluese:

Plotesimi i kerkesave te komunitetit, ruajtja dhe mirembajtja e infrastruktures rrugorete zones, punesimi i komunitetit te zones, rritja e investimeve ne sektore te ndryshem dhe kontributi ne taksat vendore. Krijimi i kushteve te mira te punes, siguri ne pune dhe zbatimi i kushteve teknike duke investuar ne hapjen dhe mirembajtjen e minieres.

Ndikimet qe shkaktojne ndryshimet klimatike, ndryshimi i klimes, emetimi i substancave ozon-holluese.

Impakti:

Projekti ne vleresim nuk do te perfshije substanca te tilla qe mund te ndikojne ne rritjen e perqendrimit te lendeve ozon-holluese ne atmosfere. Vleresohet vetem lenda djegese e mjeteve te renda te punimeve te germimit, megjithese ne nivele te uleta. Faktor tjetër negativ mund te vleresohet reduktimi i bimesise se zones dhe pakesimi i filtrimit

Masa parandaluese:

Rehabilitimin e mjedisit te demtuar dhe mbjelljen e pemeve ne raport 1me 3

Projektoi: "STUDIOPROJEKT" shpk. Tirane

Adresa: Rr. Ndre MJEDA, Rezidenca Eagle, njesia 3006. Tirane

Telefon: 0682056654

e- Mail: studioprojekt@yahoo.it

Ndikimet nderkufitare

Projekti ne vleresim nuk prek mjedisin kufitar. "nuk ben pjese ne projektet me ndikim nderkufitar, shfrytezim te ujrave ndërkombëtare" dhe projekte te "Sigurisë së Digave" pasi ky projekt do te jete ne brendesi te territorit te vendit dhe nuk perdor burime ujore. Siperfaqja e demtuar nga zbatimi i ketij projekti, mund te rehabilitohet dhe te ripyllezohet ne pjesen me te madhe te saj, pothuajse ne masen 100% te siperfaqes.

Menaxhimi i mbetjeve te ngurta

Nga punimet e zbatimit eshte vleresuar nje sasi minimale sterileshe te cilat kane nevojte te menaxhohen per te mos u shnderruar ne nje problem mjedisor. Nuk do te ndertohet landfill per depozitim inertesh, ato do te perdoren si stabilizant per shtrim rruges.

Infrastruktura shtese ne funksion te projektit

kryesor te shfrytezimit te mineralit te materileve ndertimore gur gelqeror

Per hapjen e karieres do te ndertohet nje rruge kantjeri me gjatesi 600m ne teritorin e lejes minerare te shfrytezimit. Shpenzimet per hapje e karieres do te behen nga investitori. Per venjen ne shfrytezim te ketij objekti nuk do te ket ndertime rruges jasht zones se projektit.

Hapja e karieres fillon ne kuoten +210m qe perkon me rrugen ekzistuese te zones dhe do te ngjitet deri ne kuoten+260m qe eshte sheshi shkalles se pare te shfrytezimit te gurit gelqeror. Ndersa skarpata e shkalles fundore e shfrytezimit do te jete kuota +270m

PLANI I MENAXHIMIT TE MJEDISIT

DHE KONSULTIMI ME PUBLIKUN E PALET E INTERESIT

Te pergjithshme

Ky seksion perfshin pershkrimin e Planit te Menaxhimit Mjedisor (PMM) te projektit.

Qellimi kryesor i PMM, eshte te siguroje nje proces sa me pak te demshem per mjedisin nepermjet masave rehabilituese te cilat do te minimizonin demtimin e mjedisit dhe rekuperimin e tij. PMM dhe Programi i Monitorimit Mjedisor do te jete ne formen e nje drafti ne menyre qe te siguroje implementimin e rekomandimeve parandaluese te ndikimit te mundshem mjedisore te anashkaluar ne raportin e VNM-se Pavaresisht nga kjo, PMM stimulon procedurat dhe rregullat qe duhet te ndiqen gjate shfrytezimit te mineraleve.

Plani i menaxhimit te mjedisit te demtuar nga zbatimi i ketij projekti

Ky plan synon minimizimin e ndikimeve ne mjedis duke marre masa specifike per cdo ndikim ne mjedis dhe do të vleresohet si pjesë e procesit të zbatimit të projektit për të zbutur ndikimet e mundshme nga aktivitetet.

Masat lehtesuese kryesore do te perfshihen por nuk do te limitohen ne kete pike pasi gjate punimeve mund te kete ndryshime dhe probleme qe mund te shoqerohen me ndikim ne mjedis.

Nder te tjera eshte projektuar qe te kihet parasysh nga investitori:

- Perzgjedhja optimale e kapaciteteve dhe e menyres se shfrytezimit.
- Parandalimi i krijimit te trafikut ne zone;

- Dëmtimi i mjedisit pyjor në minimumin e lejuar
- Masat për reduktimin e pluhurave nga punimet
- Masat për reduktimin e zhurmës;
- Masa për rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara duke minimizuar erozionin dhe duke zbatuar Me përpiktmeri projektin e rehabilitimit të mjedisit të hartuar që në fazën para fillimit të punimeve.
- Respektimin e kushteve të lejes/deklarates mjedisore të leshuar

Aspektet sociale, konsultimi dhe informimi i publikut

Analiza sociale.

Projekti duhet të kalojë në vlerësim të gjere institucional dhe social gjatë fazës së projektimit dhe përgatitjes, popullatës lokale ky zhvillim prezantohet në fazën e hartimit të raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Prezantimi duhet të jetë i përgjithshëm për projektin dhe me karakter informues në lidhje me ndikimet negative dhe pozitive në mjedisin biologjik dhe atë social. Vetëm pas konstatimit të shqetësimeve dhe kërkesave të publikut lokal projekti i propozuar mund të miratohet pasi mund të jetë e nevojshme për rritjen e investimit për të realizuar një investim në shërbim të komunitetit të zonës.

Gjatë përgatitjes së projektit konsultimi me institucionet përkatëse është mbajtur me një gamë të gjerë të palëve të interesuara. Në fazën e miratimit të koncesionit janë marrë të gjitha miratimet e institucioneve të linjës, si ministria e mjedisit, bujqësisë, e kulturës, e transporteve, avokati shtetit, etj dhe një sërë drejtorish në varesi të tyre.

Për realizimin e procedurës së konsultimit me publikun është zbatuar procedura ligjore në fuqi sic është VKM Nr. 247, datë 30.04.2014 "Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin" dhe një përmbledhje joteknike e raportit të VNM është vendë në dispozicion të publikut përmes faqes së web-it të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Drejtorisë Rajonale të Mjedisit dhe Njesisë së Qeverisjes Vendore.

Procesi i konsultimit dhe informimit të publikut gjatë përgatitjes së raportit të thelluar të VNM-së realizohet duke përfshirë takime me përfaqësuesit e komunitetit, përfaqësues të Njesisë së Qeverisjes Vendore, Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, e autorizuar nga AKM-ja, subjekti investitor dhe ekspertet e hartimit të raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe projektit të rehabilitimit të mjedisit.

Këto konsultime janë të domosdoshme dhe realizohen në kuadër të ruajtjes së cilësive të mjedisit dhe jetës së komuniteteve por edhe në kuadër të zbatimit të kuadrit ligjor vendas dhe atij ndërkombëtar të ratifikuar me konvente nga vendi ynë (Konventa) Aarhus).

Pas përfundimit të takimit, rezultatet, kërkesat, debatet e parashtruara, pasqyrohen në raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, si pjesë integrale e tijë dhe si informacion për vendimarrësit.

MONITORIMI I MJEDISIT GJATË ZBATIMIT

TE PUNIMEVE TË NDERTIMIT DHE TË REHABILITIMIT TË MJEDISIT.

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokës dhe mjedisit biologjik, kryhet sipas disa kritereve shkencore për të përket vërtetimit, mbledhjes dhe analizave të mostrave. Aisynon në

mbledhjen e te dhenave per te vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror ne ndryshimet e mjedisit, ku ai eshte aktiv.

Objektivat kryesore te monitorimit jane:

- Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktesisht nga ana sasore tendencat e zhvillimit te burimeve ndotese.
- Per te siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) te burimeve ndotese dhe shkaqeve te tyre.
- Per te evidentuar cilesine e mjedisese ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor, me synim per te marre masat e nevojshme per permiresimin e tyre.
- Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi eshte detyre e shoqerise investitore ne nivel individual per pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 te Vendimit Nr.1189. date 18.11.2009 Per monitorimet ne Republiken e Shqiperise

Investitori do te monitoroje keto treguese te trysnise ne mjedis vetem gjate fazes se punimeve ndertimore dhe te shfrytezimit, konkretisht elementet e meposhtem:

- Per ajrin duhet te monitoroje Lenden e Ngurte Pezull(LNP) dhe zhurmat (dB).
- Per ujin, duhet te monitoroje Lenden e Ngurte Pezull(LNP).
- Per token, ne zbatim te kerkesave te pervaktuara ne lejen mjedisore.

Frekuenca e monitorimeve do te percaktohet ne aktin e miratimit te lejes se mjedisit dhe ne rast te kundert, sipas kuadrit ligjor cdo 6 muaj te kryhen matjet dhe cdo tre muaj te dorezohet nje relacion periodik i shkurter ku te pasqyrohen punimet e kryera te shoqeruara me foto.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME PËR PROJEKTIN

Në përfundim të studimit nxjerrim keto përfundime dhe rekomandime te nevojshme për të bërë të mundur zbatimin e projektit me ndikime sa më të pakta në mjedis nga subjekti "PAJO 2010" shpk

Përfundime

Ky projekt ze nje siperfaqe relativisht te vogel 0.0305km2 me aktivitet per 25vjete, si rrjedhoje do te shoqerohet me ndikime minimale ne mjedis. Ne rast se do te zbatohen masat zbutese dhe rekomandimet e ketij raporti, keto ndikime vleresohet te reduktohen ne masen me te madhe te tyre. Ky aktivitet shoqerohet me ndikime minimale te mjedisit te zones, por gjithashtu edhe me perfitime te medha ekonomike per rajonin dhe ne rang kombetar.

Duke vleresuar perfitimet ekonomike dhe duke pasur ne konsiderate rehabilitimin e plote te siperfaqeve te demtuara, ky aktivitet mund te zhvillohet ne pajtueshmeri me mjedisin biologjik dhe ate human.

Rekomandime

Si eksperte mjedisore dhe si autore te ketij raporti, me qëllim që të kemi nje ndikim minimal ne mjedisin e zones ne teresi nga zbatimi i projektit, rekomandojmë:

Projektoi: "STUDIOPROJEKT" shpk. Tirane

Adresa: Rr. Ndre MJEDA, Rezidenca Eagle, njesia 3006. Tirane

Telefon: 0682056654

e- Mail: studioprojekt@yahoo.it

Subjekti "PAJO 2010" Shpk

- Te perdoret sasia e dheut te krijuar nga germimet per te rehabilituar siperfaqet e demtuara, si dhe tepricat e depozitohen ne vende te caktuara nga pushteti vendor, ose te menaxhohen ne menyre te pa demshme per mjedisin.
 - Te regjistrohen pemet e prera dhe te mbillen bimesi autoktone ne siperfaqet e demtuara pas sistemimit te tyre me dheun e germuar nga siperfaqja. (Sipas projektit te rehabilitimit ne raport 1 me 3)
 - Te aplikohet lagja e rrugeve dhe kantieri me qellim reduktimin e pluhurit. Ujerat e kantierit te orientohen me sistem kanalizimi drejt kolektorit kryesor ose dhe e shoqeruar me vaske dekantim
 - Te respektohen kushtet dhe rregullat e mbrojtjes ndaj zjarrit ne zone pyjore.
 - Te respektohen detyrimet dhe kushtet e vena ne lejen/deklaraten mjedisore nga Ministria e Mjedisit.
 - Te kryhet monitorimi periodik i aktivitetit gjate fazes se ndertimit dhe gjate fazes se funksionimit te aktivitetit. Keto te dhena te monitorimit te dorezohen rregullisht prane Drejtorise Rajonale te Mjedisit te Prefektures perkatese, si dhe te vihen ne dispozicion te publikut te gjere dhe organizmave te tjera te identifikuara si pale te prekura ose pale interesi.
 - Te kryhet sa here te jete e kerkuar nga pushteti lokal apo banoret konsultimi me komunitetin e gjere dhe sqarime te paqartesive te tyre ne lidhje me zbatimin me rigorozitet te projektit dhe lejimin e ujit te bollshem per nevojat e tyre.
 - Projekti teknik i shfrytezimit te gurit gelqeror me kariere te zbatohet me perpiktmeri dhe brenda siperfaqeve te paracaktuara, duke zbatuar edhe rregullat e sigurimit teknik ne miniera dhe rregulloren e puneve me lende plasese.
 - Detyrimisht investitori te gjelberoje dhe rehabilitoje zonen se demtuar nga aktiviteti minerar.
 - Ne rast se konstatohet objekte apo shenja te vlerave arkeologjike te njoftohen institucionet perkatese dhe te ndalohen perkohesisht punimet
 - Te kryehen punimet e sistemimit dhe rehabilitimit te teritorit te prekur nga aktiviteti te cilat jane trajtuar ne Planin e Rehabilitimit te Mjedisit.
 - Gjithashtu nje synim tjeter eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative per zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zvillimit te aktivitetit
- Ne hapjen dhe shfrytezimin e objekti, shoqeria do te marre te gjitha masat per zbatimin me perpikmeri te projektit te hartuar qe ai te siguroje nje zhvillim normal te procesit te nxjerrjes dhe prodhimit te gurit gelqeror pa demtuar mjedisin dhe shendetin e njerzve.
Ju falenderojme për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

Materiali u pergatit me grup pune nga STUDIOPROJEKT shpk
Ekspert mjedisi Ing. Xhevat DERMISHI
Gjeoinxhinier Ermir DERMISHI

